

PËRCJELLJA E TRASHËGIMISË KULTURORE PËRMES LETËRSISË DHE LETËRSIA SI TRASHËGIMI KULTURORE

Dr. MARSELA LIKAJ

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës
marsela.likaj@unitir.edu.al

Msc. ARGIDA SHIJAKU

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës
argida.shijaku@unitir.edu.al

Abstract

This paper aims to address the interactive relationship between literature and cultural heritage. Literature is seen as a means of transmitting cultural heritage to other languages and cultures, but on the other hand, in its role as a “site of memory”, it provides evidence of everyday life and thus a glimpse into a certain social reality. Literature as a “site of memory” offers the possibility, as with a memorial, to return to a place and address a theme. Like a place of remembrance, literature can open up new perspectives and highlight details. Literature cannot replace a “site visit”, but it can bring places to life, make them come alive and, through its ability to create images, impress thoughts that are unforgettable. “Literature as a *site of memory*” is created in very different biographical backgrounds. “Chronicle in stone” (Kadare), “Confessions of Lost Places” (Besa Muftiu), “The Eternal Life of the Albanians” (Ornela Vorpsi) are used here as example texts, which from different perspectives, offer “site of memory”.

Keywords: cultural heritage, place of memory, literature.

Letërsia mund të shërbejë si një “vend kujtese”. Sipas Nora-s, “vend kujtese” është çdo entitet domethënës, qoftë ky i një natyre materiale apo jomateriale, i cili për shkak të vullnetit njerëzor ose kohës është bërë një element simbolik i trashëgimisë përkujtimore të një komuniteti¹. Në këtë këndvështrim, tekstet autobiografike letrare ofrojnë elemente, të cilat shërbejnë si dëshmi për jetën e përditshme në një periudhë të caktuar kohore në një realitet të caktuar shoqëror.

Kush i krijon “vendet e kujtesës”? Të mbijetuarit, historianët, artistët, shkrimtarët. Nëse i referohemi këtyre të fundit, në tekstet e tyre ata fokusohen në kohë, vende dhe njerëz të veçantë. Autori zgjedh motivet, njerëzit, gjuhën dhe formën e tekstit. Ai gjithashtu ofron një perspektivë të caktuar dhe ka një synim. Lexuesi, që nuk ka qenë më parë në një vend të caktuar, duhet ta përfytyrojë atë vend në mendjen e tij jonë planin konkret, por më tepër për të kuptuar atë që ndodh.

Letërsia, si një “vend kujtese”, ofron mundësinë që t’i rikthehesh një vendi, jo gjeografikisht por literalisht. Ashtu si një vend gjeografik, apo si një memorial, letërsia mund të hapë perspektiva të reja dhe të nxjerrë në pah detaje. Letërsia nuk mund të zëvendësojë një “vizitë në vend”, por ajo mund t’i mbushë vendet me jetë, t’i bëjë ato të gjallërohen. Për shkak të aftësisë së saj për të krijuar imazhe, ajo është në gjendje të ngulitë mendime apo të krijojë përfytyrime e përjetime që mbeten të paharrueshme.

Letërsia krijohet në sfone biografike shumë të ndryshme, kështu që edhe tekstet e marra në shqyrtim në këtë studim lexohen në kontekste të ndryshme. Le të marrim si pikënisje qytetin dhe shkrimin letrar për qytetin. Në mënyrë analoge me një koncept urban, mund të flasim për imazhin e një qyteti që përcjell letërsia artistike apo letërsia e udhëtimeve.

Për shembull “**Kronikë në gur**” e shkrimtarit Ismail Kadare vjen si një “monument letrar” për qytetin antik në jug të Shqipërisë, Gjirokastrën. Në këtë vepër ndërthuren mrekullisht historia botërore, mitet e vjetra dhe perceptimi femënor, të gjitha këto të vendosura së bashku në një qytet të caktuar dhe në një periudhë kohore të caktuar që përbëjnë edhe bazamentin real të veprës.

¹ Koncepti vjen nga Pierre Nora, “Between Memory and History: Les Lieux de Mémoire”, Spring 1989.

Imazhi i një qyteti krijohet përgjithësisht si rezultat i studimit afatgjatë të një morie elementësh dhe marrëdhënieve të tyre, mbi bazën e të cilave realizojmë një tablo komplekse të qytetit. Marrja parasysh e këtyre elementeve është e një rëndësie të madhe, veçanërisht për autorin, i cili përpiqet të krijojë një paraqitje vizuale sa më cilësore e gati ideale të vendbanimeve.

Me interes të veçantë për studimin tonë janë ato fragmente nga teksti letrar, të cilat, nëpërmjet përshkrimit të qytetit, kontribuojnë në një karakterizim të banorëve të qytetit dhe ndihmojnë në zbulimin e jetës së tyre vetjake në jetën komunitare. Duke 'ndërruar' perspektivën, përshkrimi i qytetit është në gjendje të identifikojë vëzhguesin dhe t'i bëjë ndjenjat dhe mendimet e tij të lexueshme në mënyrë figurative.

Megjithëse perceptimi i një qyteti përcaktohet nga një sërë faktorësh subjektivë, imazhi i krijuar dëshmon edhe një shkallë të caktuar objektiviteti. Autori harton për lexuesin një lloj katalogu dukurish, me informacion të detajuar për kushtet klimaterike, mënyrën e jetesës së popullsisë, karakterin e tyre, mënyrën se si e trajtojnë historinë etj. Forma narrative e lejon vëzhguesin të ndërveprojë me objektin e vëzhguar, në këtë rast me qytetin.

Qyteti në romanin "Kronikë në gur" është një qytet i vogël, i çuditshëm, i pjerrët, i gurtë, përrallor që nuk ngjan me asnjë tjetër. Ismail Kadare e përshkruan në këtë mënyrë:

"Ishte një qytet i çuditshëm që dukej sikur ishte shfaqur befas në luginë një natë dimri si një qenie e lashtë, dhe më pas, duke u përpjekur të ngjitej lart, u ngul në shpatin e malit. Gjithçka në këtë qytet ishte e vjetër dhe prej guri, rrugët dhe burimet si dhe çatitë e shtëpive të tij të fuqishme shekullore, të cilat ishin të mbuluara me pllaka guri gri që dukeshin si luspa të mëdha."

Autori tregon historinë e vendlindjes së tij, Gjirokastrës, duke përshkruar elementet tipike të qytetit, si shtëpitë, rrugët prej kalldrëmi, kështjellën, sheshin qendror, xhaminë, tregun, etj. Qyteti shtrihet në një kodër me rrugë të pjerrëta dhe kështjella qëndron si një kurorë në majë. Edhe përshkrimi i këtij qyteti është magjik. "Ky është një qytet i gurtë" ku përcaktimi "i gurtë" nuk flet vetëm për materialin, por flet simbolikisht edhe për historinë dhe qëndrueshmërinë e qytetit. Ai krahasohet me një krijesë të çuditshme. Metaforikisht, jeta në këtë

qytet gjallon brenda guaskës së gurtë, edhe pse nga jashtë duket e paimagjinueshme. Nga këndvështrimi i një djali të vogël tregohet përditshmëria normale dhe bashkëjetesa në një familje të madhe. Me personazhin kryesor zbulohen dimensione të ndryshme të qytetit. Me të drejtë kritiku Enzensberger e cilëson paraqitjen e qytetit në këtë vepër si të stilizuar mjeshtërisht, ku individualizmi i rafinuar ndërthuret me përgjithësimin, duke krijuar një botë poetike që del edhe përtej emërtimeve lokale (krahajo: Enzensberger: 1988).

“Ky ishte një qytet i pjerrët, ndoshta më i pjerrëti në botë, që i kishte thyer të gjitha ligjet e arkitekturës dhe të urbanistikës. Nga shkaku i pjerrësisë së madhe ndodhte që në nivelin e çatisë së njëres shtëpi gjendeshin themelet e tjetrës, dhe me siguri ky ishte i vetmi vend në botë ku njeriu, po të rrëzohej në anë të rrugës, në vend që të binte në hendek, mund të binte mbi çatinë e ndonjë shtëpie të lartë. Këtë gjë më mirë se kushdo e dinin pijanecët. Ishte me të vërtetë një qytet shumë i çuditshëm. Ti mund të ecje rrugës dhe po të doje, mund të zgjatje pak krahun dhe ta vije kapelën tënde mbi majën e një minareje. Shumë gjëra këtu ishin të pabesueshme dhe shumë gjëra ishin si në ëndrra.”²

Shembulli i mësipërm fokusohet në mënyrën se si është ndërtuar qyteti në shpat mali që, sipas Myftarajt, argumentohet me faktin që gjirokastritët ishin rebelë ndaj pushtuesve osmanë dhe donin të mbroheshin nga ndëshkimi në rast rebelimi³. Teksti lë kështu një dëshmi të shkruar për këtë qytezë, si në lidhje me arkitekturën e qytetit ashtu edhe me faktet historike që e kanë formësuar. Autori e lë procesin e përshkrimit të hapur, në mënyrë që të mundësohet edhe imagjinata individuale e lexuesit. Imazhi i qytetit krijon njëfarë magjepsjeje. Ai krijon një tablo imagjinare të qytetit jo vetëm përmes gjuhës figurative, por më tepër për shkak të shembujve të zgjedhur mbi bazën e të cilave ndërton metaforat, duke theksuar një elemente krejt të veçanta në arkitekturën e këtij qyteti. Ky lloj stilizimi e nxit imagjinatën dhe kuriozitetin e lexuesit në mënyrë të jashtëzakonshme, duke e kthyer tekstin në një referencë gjeografike të dëshiruar për t’u

² Ismail Kadare: «Kronikë në gur», «Naim Frashëri», Tiranë, 1978, fq. 3-4.

³ Myftaraj K. (2008), Gjyqi intelektual i Kadaresë, cit. Shkupi press, dt. 23 nëntor 2012.

vizituar. Ky është një fragment, i cili është kthyer në simbol të qytetit dhe citohet edhe në udhëzuesit turistike për Shqipërinë të shkruar nga të huajt.

“Ismail Kadare, shkrimtari më i rëndësishëm bashkëkohor shqiptar dhe i përmendur vazhdimisht si kandidat për çmimin Nobel, vjen nga peizazhi i thyer në jug të vendit. Ai lindi në Gjirokastrë, një qytet prej guri, i kapur pas shkëmbinjsh pothuajse vertikalë. Çdo shtëpi duket si një kështjellë më vete, me mure të trasha dhe çati të rënda të bëra me gurë me shtresa, shpesh me një oborr dhe cisternën e vet. Mbi to ngrihet një kështjellë madhështore shkëmbore, një fortesë kolosale që dominon luginën e madhe të lumit të Drinos dhe shpatet përballë maleve⁴” (përkthim i autores së artikullit).

Kur arkitektët, filozofët apo historianët e kulturës flasin për zhvillimin e vendbanimeve urbane sot, shpesh dëgjojmë që qyteti të humbasë fytyrën e tij apo edhe të zhduket. Përcaktime të tilla dhe të ngjashme përpiqen të pasqyrojnë në mënyrë kritike ndryshimin aktual dinamik të qytetit. Jo rrallë, ndryshimet urbanistike dhe arkitektoore shoqërohen me dëme të pariparueshme apo me ndërprerjen e vazhdimësisë historike. Një konstatim i tillë, shpesh, ka qenë i dhimbshëm për banorët e qyteteve evropiane në shekullin e 20-të. Një gjë e ngjashme mund të thuhet edhe për pjesën e re të qytetit të Gjirokastrës, ndonëse pjesa e vjetër, ajo që Kadareja e përshkruan mjeshhtërisht, po e ruan funksionin e ruajtjes së trashëgimisë kulturore.

“Në pjesën veriore të lagjes kalonte rruga e kalasë, që lidhte lagjet e sipërme të qytetit me qendrën. Rruga ishte shumë lart në krahasim me nivelin e çatisë së dy shtëpive të vetme të lagjes dhe njëherë një kamion që u rrëzua, dëmtoi rëndë hajatin e shtëpisë së babazotit. Nganjëherë qëllonte që rrëzohej ndonjë i pirë dhe çatia pikonte një javë rresht⁵” – përshkruan Kadare.

Nëse, sot, qyteti ka pësuar ndryshime dhe nëse aty ku dikur qëndronin vetëm ato dy shtëpi gjenden tashmë disa të tilla, apo edhe plot ndërtesa të tjera, atëherë fytyra e vjetër e qytetit ka mbetur e fiksuar

⁴ FAZ dt. 28.03.2008.

⁵ Ismail Kadare: «Kronikë në gur», «Naim Frashëri», Tiranë, 1978.

në faqet e këtij libri. Për shumë njerëz që e kanë përjetuar qytetin siç e përshkruan Kadare, vetë romani do të shërbejë si një “vend kujtese”, duke përcjellë një pjesë të trashëgimisë sonë kulturore. Me librin si “vend kujtese, imazhi i vjetër i një qyteti nuk humbet. Dhe cilido që dëshiron t’u tregojë fëmijëve apo pasardhësve për të shkuarën, mund të përdorë librin për të ilustruar shumë mirë historinë e vet.

Duke iu kthyer Nora-s, “entiteti qytet”, pra Gjirokastra në veprën “Kronikë në gur” do të ishte një element i një natyre “materiale”, i cili merr funksionin e “vendit të kujtesës”. Si element të një natyre “jo materiale” do të marrim “jetën nën diktaturën e komunizmit në Shqipëri” të trajtuar në dy vepra me tematikë të ngjashme, “Rrëfime nga vendet e harruara” e autores Besa Myftiu dhe “Vendi ku nuk vdiset kurrë” e autores Ornela Vorpsi.

Nëse do të bëjmë një analizë të tipologjisë së tematikave në veprat e shkruara pas viteve nëntëdhjetë do të identifikonim kthimin në vitet e fëmijërisë tek një sërë autorësh. Këtu spikatin edhe dy romanet e lartpërmendura. Këto vepra kanë të njëjtën sfond kohor, vitet e regjimit të Enver Hoxhës, sikurse edhe ngjarjet zhvillohen në të njëjtin vend gjeografik, në qytetin e Tiranës. Të dyja këto romane kanë elemente autobiografike. Shkrimtarja Besa Myftiu eksploron “vendet e harruara” të fëmijërisë së saj duke i kthyer përmes letërsisë në vende kujtese. Autorja përshkruan botën e zhdukur të fëmijërisë së saj në vitet 1960 dhe 1970. Vajza rritet në një lagje në Tiranë, ku jeton me familjen, fqinjët dhe miqtë e saj dhe vëzhgon me detaje gjithçka përreth. Nga këndvështrimi i një vajze të vogël, si alter egoja e saj, autorja tregon për familjen, anëtarët e së cilës zhvillojnë strategjitë e tyre përballë represionit shtetëror të regjimit të kohës. Koha, regjimi, ngjarjet kanë lënë gjurmë të thella tek njerëzit sikurse edhe tek qyteti.

“SHTËPIA IME ka vendosur të vrasë veten. E lumtur në kohën e mbretit Zog, guximtare gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare, optimiste në periudhën e komunizmit, ajo është zhytur në melankoli të thellë që prej dhjetë vjetësh. Në fillim i morën një copë të vogël nga kopshti për të ndërtuar një dhomëz ku do të vendoseshin dy makinat e shtypshkronjës së tim vëllai. U desh të pritej fiku gjethegjërë... Mbi trungun e tij të rrafshuar, muratorët vendosën pllakat ngjyrë gri të dyshemesë. Nga dritaret e katit të parë Shtëpia vështronte me hidhërim këtë përzgjatje

të shëmtuar të saj, bërë prej betoni me cilësi të ulët; në netët me shi, lot të mëdhenj i rrëshqisnin përgjatë fasadës.⁶

Nëse do të analizonim fragmentin e mësipërm, fokusi i autores është i ndarë midis “materiales”, që në këtë rast do të ishte shtëpia, dhe “jo materiales”, që përfshin ndryshimet në planin historik, ekonomik dhe social që ka pësuar shoqëria shqiptare përgjatë shekullit të njëzetë. Për sa i përket entitetit “qytet” evidentohen ndryshime urbane që do të përshkruheshin si ngushtim i hapësirës së gjelbër, betonizim i qytetit etj., elemente këto që përcillen jo pozitivisht në shoqëri. Nëse do të flisnim për trashëgiminë kulturore, më tepër se sa në planin material ato evidentohen në planin historik dhe social. Në këtë kuptim, “lumturia” në kohën e mbretit Zog, “guximi” i shfaqur gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare, optimizmi në periudhën e komunizmit dhe melankolia në periudhën kaotike të ndërrimit të sistemit do të shërbenin si entitete “jo materiale” që do ta shënjonin këtë roman si “vend kujtese”.

“Shqipëria është vendi ku askush nuk vdes”, kështu fillon romani i Ornela Vorpsit, i cili tregon për vendin ndoshta më ekzotik në Evropë në atë kohë, mbushur me bunkerë dhe me një parti që kontrollonte gjithçka dhe këdo. Koha duket sikur ka ndalur për më shumë se gjysmë shekulli. Me një perspektivë krejt origjinale Vorpsi kërkon të memorizojë në fjalën e shkruar fëmijërinë e tyre dhe jetën nën regjimin totalitar. Jo gjithçka që përshkruajnë këta autorë e kanë përjetuar vetë, por gjithçka ka ndodhur realisht, siç thekson Ornela Vorpsi në intervistën e dhënë për ORF1:

“Thjesht doja të tregoja përditshmërinë e një shqiptari që jetonte në shtetin totalitar të Enver Hoxhës. Deri vonë, letërsinë në Shqipëri e bënin vetëm njerëz të mbrojtur nga partia. Njerëzit e dënuar nuk kishin zë në këtë vend dhe unë isha një person i tillë”.

Duke ndërthurur mjeshtërisht zhgënjimin dhe talljen, secila prej këtyre autoreve evokon një botë të vetën, atë të një shtëpie, të një familjeje, të një rruge dhe të banorëve të saj në Shqipërinë e Enver Hoxhës, ku urrejtja dhe dashuria janë shumë pranë njëra-tjetrës.

⁶ Myftiu B. (2010) Rrëfime nga vendet e haruara, kreu 3, Dudaj, Tiranë.

⁷ ORF 1, Eine Kindheit im Hoxha-Regime, dt. 08.04.2017.

Përmes autobiografive të tyre, ato sjellin njëkohësisht tablo të jetës së përditshme në diktaturë. Kjo nuk është vetëm bota e secilës prej tyre, por e gjithë shoqërisë shqiptare të atyre viteve, prandaj me të drejtë kritika ndërkombëtare i ka shoqëruar botimet e këtyre romaneve në gjuhë të huaja me tituj si *Përditshmëria në diktaturën shqiptare*⁸ apo *Një fëmijëri në regjimin e Hoxhës*⁹.

Është interesant fakti që përshkrimet e Myftiut dhe Vorpsit vijnë nga pozita të një distancimi jo vetëm kohor por edhe vendor e gjuhësor. Të dyja autorët i kthehen fëmijërisë në Tiranën e viteve të komunizmit pas më shumë se një dekade, e shkruajnë veprën në periudhën kur janë në mërgim dhe gjuha në të cilën e shkruajnë nuk është gjuha e nënës, por gjuha e vendit ku kanë mërguar. Kjo do të kërkonte një analizë më të thelluar, gjithsesi relevant për ne është fakti që këto vepra qëndrojnë si “vende kujtese” ku ne shohim vetveten, të huajt mësojnë më shumë rreth nesh, ndërsa të rinjtë gjejnë të rrëfyer me një gjuhë të lehtë e të këndshme histori të një epoke të hidhur të vendit të tyre.

BIBLIOGRAFIA

Referime artikujsh

- Nora P. (1989), *Between Memory and History: Les Lieux de Mémoire* në No. 26, Special Issue: Memory and Counter-Memory (Spring, 1989), f. 7-24.
- *Frankfurter Allgemeine Zeitung*, dt. 28.03.2008.
- Enzensberger U. (1988), *Vaterland und Heldenmut* në *Die Zeit* dt. 18.11.1988.
- Myftaraj K. (2008), *Gjyqi intelektual i Kadaresë*, cit. Shkupi press, dt. 23 nëntor 2012.
- Magenau J. (2022) *Alltag in der albanischen Diktatur* në Deutschlandfunk Kultur dt. 14.06.2022.
- ORF 1, *Eine Kindheit im Hoxha-Regime*, dt. 08.04.2017.

Referime librash

Kadare I. (1978) *Kronikë në gur*, Naim Frashëri, Tiranë.
Kadare I. (1999) *Chronik in Stein*, dtv, München.
Myftiu B. (2010) *Rrëfime nga vendet e harruara*, Dudaj, Tiranë.
Myftiu B. (2007) *Confessions des lieux disparus*, L’aube, Paris.
Vorpsi O. (2007) *“Das ewige Leben der Albaner”*, Zsolnay Verlag, Wien.

⁸ Magenau J. (2022) *Alltag in der albanischen Diktatur* në Deutschlandfunk Kultur dt. 14.06.2022.

⁹ ORF 1, *Eine Kindheit im Hoxha-Regime*, dt. 08.04.2017.